

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, gjyqtari Enes Mehmeti, me sekretaren juridike Minire Krasniqi, ne ceshtjen juridiko-kontestimore te inicuar me padine e paditeses Kompania e Sigurimeve '██████████' J.S.C me seli në Prishtinë rr. '██████████' nr.████ kundër të paditurit '██████████' nga Shtime rr. '██████████' p.n., për çështjen juridike rimbursim dëmi, jashte séance me date 17.07.2018, merr ketë:

## **A K T G J Y K I M**

### ***-PER SHKAK TE PADEGJUESHMERISE/MOSBINDJES-***

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve '██████████' J.S.C me seli në Prishtinë rr. '██████████' nr.████, si e bazuar.

**DETYROHET** i padituri '██████████' nga Shtime rr. '██████████' p.n., qe paditëses t'ia paguan shumën prej 307.98€, me kamat ligjore nga dita e paraqitjes se padisë e deri ne pagesen definitive, si dhe shpenzimet e procedurës ne shumë prej 20€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

### **A r s y e t i m i**

Paditësja, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurit, me pretendimin se per shkak te veprimeve deliktore te te paditurit gjate pjesemarrjes ne komunikacion, ka shkaktuar aksident trafiku, me ç'rast ka shkaktuar dëme materiale, për të cilat dëme paditësja eshte detyruar qe ta kompensoj te palen e tretë, pasi qe i padituri në momentin e shkaktimit të aksidentit nuk ka poseduar patentë shofer (leje të vozitjes), andaj në bazë të ligjit mbi autopërgjegjësin e njejta kërkon rimbursimin e dëmit të paguar palëve të treta.

Paditesja, gjykatës i kanë bashkangjitur provat dhe dëshmitë tjera material, per kompensimin e palës së dëmtuar respektivisht kompensimin e dëmit materiale, nga ky aksident trafiku.

Gjykata, te paditurit me datë 30.04.2018, i ka dorezuar padinë së bashku me provat e lëndës si dhe aktvendimin për përgjigje në padinë e paditësit, por i paditurit brenda afatit të caktuar ligjor, me aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi, nuk kanë ushtruar në këtë gjykatë përgjigjen e tij nëse e kundërtshojnë apo jo kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa gjykata nga provat e çështjes ka gjetur se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet e tilla nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga paditësja, si dhe duke pasur parasysh faktin se i padituri ka pranuar me rregull padine me prova dhe aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata bazuar në nenin 150.6 të LPK-së ka vendosur që të marrë aktgjykim kontumacional, pa dëgjimin e palëve ndërgjygjëse.


Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë nga neni 150.2 të LPK-së, që përjashton mundësin për nxjerrjen e aktgjykimit të tillë, në rastin konkret.

Gjykata lidhur me kamaten ka vendosur në bazë të nenit 382 të LMD-se, duke qenë se për paditësin lartësia e borxhit, ka qenë e përcaktuar që në kohën e ngritjes së padisë.

Gjykata ka obliguar të paditurin për kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore në baze të nenit 452.1 të LPK-se, ndërsa paditësin në bazë të UA nr.01/2017 të KGJK-se, për unifikimin e taksave gjyqesore.

### GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.292/18, me datë 17.07.2018



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kunder ketij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh në gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kesaj Gjykate. Afati fillon nga dita e nesërme e pranimit të ketij aktgjykimi.

